



Data: 06.03.2019

Ref.: 368/19 D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 63-të, të mbajtur më 27 shkurt 2019, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht ankesa Nr.221/19H, datë 15.02.2019 e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", si e bazuar, ndryshohet pika I (një) e vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.140/19D, datë 05.02.2019.
- II. Anulohet tërheqja e akreditimit sipas pikës I (një) të vendimit të KSHC-së Nr.140/19D, datë 05.02.2019 për programet e studimit:
 - Edukim Fillor, BA, 240 ECTS;
 - Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS, dhe
 - Infermieri, BSc, 180 ECTS.

Arsyetimi

Me qëllim të plotësimit të kriterëve formale për staf akademik sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), KShC bazuar në pikën 2.1. Neni 4 i Udhëzimit Administrativ për Akreditim (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018) dhe Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG 2015), në mbledhjen e 63-të, mbajtur më 27 shkurt 2019, vendosi që Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) të iu lejohet/pranohet riorganizimi i stafit akademik bartës të programeve, të deklaruar në afatin kohor të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018).

KSHC me vendim Nr.140/19D, datë 05.02.2019 ka tërhequr akreditimin programe të studimit të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" si në vijim: Edukim Fillor, BA, 240 ECTS; Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS; Infermieri, BSc, 180 ECTS, dhe Mami, BSc, 180, ECTS.

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë (Nr.221/19H, datë 15.02.2019) ndaj vendimit të KShC-së. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë 15 shkurt 2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës), dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Përmes kësaj ankesa, Universiteti ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi për staf shtesë për programet e studimit të cilat kanë qenë objekt i trajtimit me vendimin e KSHC-së Nr.140/19D, datë 05.02.2019.


Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 63-të të KShC-së të mbajtur me 27 shkurt 2019, dhe në fund KShC erdhi në përfundim që ankesa është pjesërisht e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programet e studimit, Edukim Fillor, BA, 240 ECTS; Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS, dhe Infermieri, BSc, 180 ECTS, i plotësojnë kushtet për të qen bartës të programeve të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për programet e studimit, Edukim Fillor, BA, 240 ECTS; Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS, dhe Infermieri, BSc, 180 ECTS, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa për programin e studimit, Mami, BSc, 180 , ECTS, KSHC vendosi që këtë çështje ta referoj për vendimmarrje në Komisionin e Ankesave, bazuar në pikën pesë të nenit 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe inicimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani";
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

